



Ministria e Financave në bazë të nenit 22 paragrafi 1 alineja 2, paragrafi 3, paragrafi 8 të Ligjit të Punësuarve në Sektorin Publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, numër 27/14, 199/14, 27/16, 35/18 dhe 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 143/19, 14/20 dhe 208/24), nenit 22 paragrafi 1 pika 1, nenit 23, nenit 24, nenit 25, nenit 26 dhe nenit 27 të Ligjit të Marrëdhënieve të Punës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16 dhe 120/18, si dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 110/19, 267/20, 151/21, 288/21, 111/23, 39/25, 74/25 dhe 124/25) dhe Rregullores së sistematizimit të vendeve të punës në Ministrinë e Financave, publikon

SHPALLJE NUMËR 10/2025 PËR PUNËSIM NË MINISTRINË E FINANCEVE

Ministria e Financave publikon shpallje për punësimin e një personi me kohë të caktuar, për shkak të rritjes së përkohshme të vëllimit të punës, për periudhë prej një viti, në këtë vend pune edhe atë:

1. Referent i pavarur për punë në zyrë, arkiv dhe arkë, Njësia Rajonale e Procedurës Administrative në Shkallën e Parë – Strumicë, Sektori i Procedurës Administrative, Drejtoria e Çështjeve Pronësore dhe Juridike – (1 realizues);

Kualifikimet e nevojshme:

- arsim të lartë/të mesëm të gjimnazit;
- së paku tri vite përvojë pune në profesion;
- njohuri aktive të njërës prej tri gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;

Orari i punës:

- Orari ditor i punës nga ora 7:30 dhe 8:30 deri në orën 15:30 dhe 16:30, orari javor i punës 40 orë – nga e hëna deri të premten;

Paga themelore neto: 27.832,00 denarë.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dëshmi për plotësimin e kushteve të cilat kërkohen për vendin e punës për të cilin aplikojnë, përkatësisht: biografi të shkurtër - CV detyrimit me kontaktin e telefonit dhe adresën; fotokopje si dëshmi për arsimin e kryer që kërkohet për vendin e punës; vërtetim nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Maqedonisë së



Veriut si dëshmi për përvojën e kërkuar të punës; fotokopje të vërtetimit të shtetësisë; fotokopje si dëshmi për njohjen e njërës prej tre gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht), si dhe fotokopje të dëshmisë së njohjes së punës me kompjuter për punë zyre.

Dokumentacioni i nevojshëm duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur në këtë adresë:

Ministria e Financave
rr. “Dame Gruev” nr. 12, 1000 Shkup
(me emërim “për shpallje punësimi”)

Në zarf duhet të shënohet numri i shpalljes dhe numri i vendit të punës për të cilin aplikon, me shënimin: “Mos e hap”.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm është tre (3) ditë pune, duke e llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes në gazetatat ditore.

Fletëparaqitja dhe dokumentacioni me vonesë, i paplotësuar dhe i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

Pas shqyrtimit të fletëparaqitjeve të parashtruara, kandidatët të cilët kanë dokumentacion të rregullt do të thirren për selektim të mëtejshëm në hapësirat e Ministrisë së Financave.

Ministria e Financave do ta kryejë përzgjedhjen në afatin e përcaktuar në përputhje me nenin 23 paragrafi 2 të Ligjit të Marrëdhënieve të Punës.

Personat kontaktues:

Lilijana Stojanovska - tel. 02/ 3255 624; lilijana.stojanovska@finance.gov.mk

Kimet Kurtishi - tel. 02/ 3255 634; kimet.kurtisi@finance.gov.mk